




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dap: <u>DPK</u>	Nr. Prot Br. Prot Prot No: <u>03-02/3004/18</u>
Nr. f. taq Broj. stranica Nr. pages: <u>02</u>	Data Datum Date: <u>21-09-2018</u>
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.08.2018, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-440/18, për z. Shafi Gashi, Anëtar i Bordit në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, për shkak se zyrtarit të lartë i ka skaduar mandati i të qenurit anëtar i Bordit në këtë Këshill.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik nr. AKK-03-02-440/18, për z. Shafi Gashi, Anëtar i Bordit në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK) dhe njëkohësisht ka pozitën e shërbyesit civil në Institutin Arkeologjik të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 06/L-011 për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, fillimisht e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Shafi Gashi me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (DPKI-03-02/1195/18). Pasi që pala ka pranuar këtë shkresë, ai është paraqitur fillimisht me telefon e pastaj është organizuar një takim me të në ambientet e Agjencisë. Gjatë këtij takimi nga zyrtari i lartë është kërkuar që të jepen sqarime lidhur me angazhimet e tija dhe po ashtu është kërkuar

përshkrimi i detyrave të punës për secilën pozitë, në mënyrë që të shihen pikat e takimit dhe të ndarjes që kanë këto pozita.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar informacion se te njëjtit i ka skaduar mandati i të qenurit Anëtar i Bordit të KKTK-së. Kjo është vërtetuar me e-mail zyrtar nga persona të autorizuar nga Administrata e Kuvendit të Kosovës.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

